

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime prioritare

Nr.	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
6	Dispozitat ligjore në lidhje me fushatën, duke përfshirë ato kundër keqpërdorimit të burimeve administrative, duhet të rishikohen për të hequr paqartësitë dhe për të garantuar një garë të barabartë. Autoritetet, duke përfshirë administratën zgjedhore dhe organet e zbatimit të ligjit, duhet t'i trajtojnë të gjithë garuesit në zgjedhje në mënyrë të barabartë.	Progres i Pamjaftueshëm	Aktualisht nuk është bërë asnjë ndërhyrje legislative për të rregulluar më mirë dhe për t`i bërë me efektive dispozitat e parashikuara në Kodin zgjedhor për financimin e fushatës dhe përdorimit të aseteve publike. Nuk ka nisma të trupës legislative për ndryshime në legjislacion, Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike dhe për financimin e tyre. Nuk janë bërë rregullimet e kërkuar ligjore për të krijuar kushte për rritjen e transparencës në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore. Efekt pozitiv në përpjekjet që synojnë zvogëlimin e hapsirave për keqpërdorimin e aseteve publike ka sjellë puna e bërë nga Komisioneri shtetror dhe angazhimi efektiv dhe intensiv i organizatave të shoqërisë civile për denoncimin dhe dënimin e këtij fenomeni. Në vijim është e domosdoshme që të realizohen ndryshimet e kërkuara në legjislacionin që trajton çështje të financimit të partive politike dhe fushatave të tyre zgjedhore. Duhet të theksohet se aktualisht, për këtë çështje të rëndësishme, shoqëria civile ka qënë e angazhuar në mënyrë intensive dhe ka hartuar dhe paraqitur propozime konkrete. Me vlerë janë edhe rezultatet e arritura në aktivitetet që ka organizuar KQZ për problemet e financimit të partive politike.